



Njoftim publik

Në Komunën e Prishtinës është dorëzuar kërkesa 05 Nr. 350/02-134706/25 dt.04.09.2025 (sipas e-Leja, KKN-00582) e pronarëve Gëzim Ajvazi, Faton Gashi dhe Dardan dhe Alban Ramadani nga Prishtina, me investitor “4 A” sh.p.k, përmes së cilës kërkohet të përcaktohen kritere të caktuara për ndërtimin e kompleksit **Comfort Residence 6**, me ndërtesën shumë banesore me afarizëm, “Ndërtesa 1”, me etazhitet B+S+P+4, në kuadër të parcelës ndërtimore të Bllokut urban “B-13”, Tërësia “B” të Planit Rregullues “Mati 1” dhe të Planit Zhvillimor Urban, në Prishtinë, në parcelën kadastrale, nr. 536-0, 537-0 dhe 538-0 ZK Matičan.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data **18.09.2025 deri më 02.10.2025**, në E-mail adresën: **urbanizmprištine@rks-gov.net**;

Kushtet e propozuara të ndërtimit:	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	Ndërtesa shumë banesore dhe afariste, “Ndërtesa 1”- B+S+P+4
b. Vija rregulluese	Sipas planit rregullues
c. Vija ndërtimore	Sipas planit rregullues
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	~15.00 m’ / 3.00 m’
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësorë dhe të pasmë të parcelës kadastrale.	~ 0.4 x H ose së paku 3 m’ (anësore) ~ 0.4 x H ose së paku 3 m’ (anësore) ~ 0.4 x H ose së paku 3 m’ (e pasme)
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHP)	40% e lejuar ~ 40.00 % e propozuar
g. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese mbi tokë në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISPN)	1.80
h. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHGJ)	40 % e lejuar 40.0 % e propozuar
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHN)	60 % e lejuar ~ 60 % e propozuar
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve	28 VP, të brendshme & të jashtme
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	Po
l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po - ☒ Jo - ☐ Nuk aplikohet - ☐	
m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe sesa zona përreth? Po - ☐ Jo - ☒ Nuk aplikohet - ☐ Sqaro:	
n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në zona të mbrojtura, zona të veçanta ose zona të veçanta të mbrojtura? Po - ☐ Jo - ☒ Nuk aplikohet - ☐ Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit administrativ 06/2017, dt. 23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, nën 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës.

Nënshkrimi i Zyrtarit:

